

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. ARQILE KOÇA

03/08/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 06.03.2019 për subjektin e rivlerësimit, z. Arqile Koça, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 08.03.2019 vendosi:

Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Arqile Koça, prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues e kryesuar nga znj. Etleda Çiftja, znj. Firdes Shuli relatores, z. Roland Ilia anëtar, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve

.

Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.